REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

Korçë, më 22/12/2021

**VENDIM**

**NR. 18 DT 22.12.2021**

**MBI NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË AUTOMJETIT TIP BENZ ME TARGË AA 323 DL**

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9 pika 1.2 gërma (c) dhe neni 77, në ligjin Nr. 10296 "Për Menaxhimin financiar" datë 08/07/2010 i ndryshuar si dhe udhëzimin nr.30 datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pika 109.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të automjetit tip Benz 124, me targë AA 323 DL
   - Me vlerë fillestare në kontabilitet 690000 lekë
   - Me vlerë të mbetur në kontabilitet 51251 lekë

2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohe Drejtoria e Financës,Zhvillimit Ekonomik, Shërbimeve, Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Territorit

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT**

**ANA VERUSHI**

Konc: Edi Qirinxhi

Juristi: Gjergji Kristo

Sekretari i Këshillit të Qarkut: Bashkim Muço

# AKT KONSTATIMI

Gjatë kontrollit teknik tip "BENZ" 124, me targa AA 323 DL, u konstatuan pjesë jashtë perdorimit si më poshtë:

1. Ferrota Para Mbrapa 4000
2. Tamburo frenosh para-Mbrapa 8000
3. Radiator 1x15000 15000
4. Bateri 100A 1x12000 12000
5. Vaj Filtra 7000
6. Testata e çarë 13000
7. Goma R.15 4x7000 28000
8. Pompë hidraulike 1x7000 7000
9. Aparat fshirëse xhami 1x4000 4000
10. Koka Pandeli 4x1500 6000
11. Pulexho transmesioni 2x2500 5000
12. Gurzhinete mesi 1x4000 4000
13. Tapiceri dhe dorezo dyersh demt. 25000
14. Puna 15000

153 000.

AUTO SERVIS MILI ... KEMBIMI

Emil Prollo

Korçe me ... 2011

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

Korçë, më 07/12/2021

**PROCESVERBAL VLERËSIMI**

I mbajtur nga Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2021, i ngritur me urdhër të Kryetarit Nr.103 Dt.07/12/2021, i përbërë nga Znj.Liljana Pici, Znj Oljona Beqiraj dhe Z.Edi Qirinxhi dhe nga ana tjetër të tre inxhinierëve mekanikë të cilët kanë kryer një kontroll të plotë të automjetit tip Benz 124 me targë AA323DL.
Nga kontrolli i kryer prej inxhinierëve mekanikë u konstatua se automjeti tip Benz 124 me targë AA323DL, është prodhim i vitit 1991 dhe është tepër i amortizuar. Ky automjet është blerë nga Institucioni i Këshillit të Qarkut Korçë në tetor 2005 dhe figuron në kontabilitet me vlerë blerjeje 690000 Lek.
Amortizimi i makinës gjatë viteve të përdorimit është pothuajse 100% dhe deri më sot vlera e mbetur është 51251 Lek.
Më poshtë është argumentimi ekonomik dhe vlera e mbetur e makinës tip Benz 124 me targë AA323DL, që mendohet të dale jashtë përdorimit.

| Nr | Emërtimi | Njësia | Cmimi i blerjes | Sipas të dhënave kontabël | | Amortizimi | | | Llogaritë e bilancit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Sasi | Vlerë | Viti i blerjes | Amortizimi akumuluar | Vlera e mbetur | |
| | Llog 215 | | | | | | | | |
| | Benz | Copë | 690000 | 1 | 690000 | Tetor 2005 | 638749 | 51251 | 2151110 |
| | Targa AA323DL | | | | | | | | |
| | **SHUMA** | | | | **690000** | | **638749** | **51251** | **2151110** |

Nga konstatimi që u bë nga inxhinierët mekanikë, rezulton se automjeti ka këto defekte:
1. Ndrim ferrotash, tamburosh, frenash para/mbrapa me vlerë afërsisht 12000 Lek
2. Radiatori është i carë dhe riparimi i tij shkon afërsisht 15000 Lek.
3. Kërkon ndrim bateri 100 Ah që kap vlerën 12000 Lek

3. Testata është e çarë dhe riparimi i saj shkon afërsisht 13000 Lek
4. Kërkon ndrim vaji, filtra, aparat fshirëse xhamash, vlera e të cilave shkon rreth 11000 Lek
5. Kërkon ndrim gomash R15 (4 cope), koka paraleli (4 copë), pulexhe transmisioni(2 copë), guzhinetë mesi(1 copë), të cilat kapin vlerën prej rreth 43000 Lek
6. Riparim të tapicerisë dhe dorezave të dyerve qe kap vlerën afërsisht 25000 Lek
7. Gjithashtu puna për riparimin e këtyre dëmeve shkon afërsisht rreth 15000 Lek
Riparimi i këtyre pjesëve kap vlerën mesatare rreth 140000 Lek.

Si rezultat i gjendjes të keqe teknike të automjetit, gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe nje konsum të lartë të karburantit.
Sa më sipër, sjellja në gjëndje pune e këtij automjeti është gati sa 3-fishi i vlerës të mbetur të automjetit, pa i diskutuar edhe faktin e vështirësisë në gjetjen e pjesëve të këmbimit për vetë faktin e vjetërsisë së mjetit.
Në këto kushte mendojmë se riparimi i këtij mjeti nuk ka efektivitet, për këtë arsye komisioni i vleresimit të aktiveve i propozon Komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi bazuar në pikën 103 gërma (d) të Udhëzimit Nr. 30 Datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, vlerëson se ky automjet duhet të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine, bazuar kjo në pikën 104 gërma (c) e Udhëzimit të sipërcituar.

Bashkengjitur këtij procesverbali janë dhe akt konstatimet të 3 specialistëve të fushës
1. Servis S.Plasari 2. Servis J.Deliu 3. Servis Mili

**KOMISIONI**

1. LILJANA PICI

2. OLJONA BEQIRAJ

3. EDI QIRINXHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

Korçë, më 09/12/2021

# PROCESVERBAL I NXJERRJES JASHTË PËRDORIMI TË "AUTOMJETIT TIP BENZ 124 ME TARGË AA323DL"

I mbajtur nga Komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2021, i ngritur me urdhër të kryëtarit Nr.104 Dt. 09/12/2021, i përbërë nga Z.Gjergji Kristo, Z.Flodi Mero, Znj. Mariela Alickolli, Znj.Paola Lara, Znj. Franceska Gjini

Komisioni në zbatim të ligjit 10296 "Për menaxhimin financiar" date 08/07/2010, i ndryshuar si dhe Udhëzimi nr.30 datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pasi analizoi edhe relacionin e Komisionit të vlerësimit të aktiveve të Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2021 në lidhje me gjëndjen fizike të automjetit tip Benz 124 me targë AA323DL, konstatoi se automjeti nuk ishte në gjëndje pune dhe se kostoja e riparimit ishte gati sa 3-fishi i vlerës të mbetur të automjetit.

Në zbatim të Udhëzimit nr.30 datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, komisioni analizoi procesverbalin e vlerësimit si dhe akt-konstatimet e kontrollit fizik dhe teknik të automjetit, nga tre specialistët e fushës që ndodhen në qytetin e Korcës nga servis S.Plasari, servis J.Deliu dhe servis Mili, të cilët:

Pas verifikimit fizik të të tre serviseve. Aritën në konkluzionin se makina tip Benz 124 me targë AA323DL kishte këto difekte:

1. Ka difekt në radiator( i carë), duhet ndërruar
2. Testata duhet ndërruar
3. Kërkon riparime xhenerike si tamburo frenash para/mbrapa, koka paraleli ,kuzhineta, ferrota, fshirëse xhamash
4. Gomat kanë tejkaluar normativën km/perdorim, kerkojnë katër goma të reja
5. Automjeti ka tapicerinë dhe dorezat e dyerve të dëmtuara
6. Vaj, filtra duhen ndërruar
7. Bateri duhet ndërruar
8. Pompë hidraulike duhet ndërruar
9. Pulexho transmisioni duhen ndërruar
10. Puna

Riparimi i këtyre pjesëve kap vlerën mesatare rreth 140000 Lek. E gjitha kjo vjen sepse makina tip Benz 124 me targë AA323DL është tip i vjetër prodhimi i vitit 1991.

Gjithashtu amortizimi i makinës gjatë viteve të përdorimit është pothuajse 100% dhe deri më sot vlera e mbetur është 51251 Lek. Ku edhe nga argumentimi ekonomik dhe vlera e mbetur e makinës tip Benz 124 me targë AA323DL, që mendohet të dalë jashtë përdorimit.

| **Nr** | **Emërtimi** | **Njësia** | **Cmimi i blerjes** | **Sipas të dhënave kontabël** | | **Amortizimi** | | | **Llogarite e bilancit** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **Sasi** | **Vlerë** | **Viti i blerjes** | **Amortizim i akumuluar** | **Vlera e mbetur** | |
| | Llog 215 | | | | | | | | |
| | Benz | Copë | 690000 | 1 | 690000 | Tetor 2005 | 638749 | 51251 | 2151110 |
| | Targa AA323DL | | | | | | | | |
| | **SHUMA** | | | | **690000** | | **638749** | **51251** | **2151110** |

Sic shihet nga analiza e kryer por edhe nga procesverbali i Komisionit të vlerësimit të aktiveve, vlera e mbetur e makinës është 51251 lekë, ndërsa vlera e Riparimeve të nevojshme është afërsisht sa 3-fishi i vlerës së mbetur. Komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktive, në zbatim të ligjit 10296 "Për menaxhimin financiar" datë 08/07/2010 si dhe Udhëzimit nr.30 datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pika 110, analizoi procesverbalin e vlerësimit si dhe akt-konstatimet e kontrollit fizik dhe teknik të automjetit, nga tre specialistët e fushës që ndodhen në qytetin e Korcës dhe në përfundim i propozon Këshillit të Qarkut të nxjerrë jashtë përdorimit automjetin tip Benz 124 me targë AA323DL.
Bashkëngjitur këtij relacioni janë: Procesverbali i Komisionit të vlerësimit të aktiveve, procesverbali i specialistëve përkatës të cilët bënë vlerësimin e makinës.

**KOMISIONI**
1. Gjergji Kristo
2. Flodi Mero
3. Mariela Alickolli
4. Paola Lara
5. Franceska Gjini